



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 20646/11 prot.

Shkodër, më 13.08.2026

NJOFTIM

Për këshillim me publikun

Në mbështetje të nenit 18 dhe neneve 89 e 90 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; në vijim të shkresës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 3523 prot., datë 31.07.2026, Këshilli Bashkiak Shkodër njofton zhvillimin e procesit të këshillimit me publikun lidhur me projektligjin:

“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Mendimet, komentet, rekomandimet dhe propozimet lidhur me projektligjin mund të paraqiten gjatë gjithë periudhës së konsultimit publik dhe deri më datë **22 shtator 2026, përfshirë këtë datë**, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- me shkrim, pranë zyrave të Bashkisë Shkodër;
- me postë, në adresën: Rr. “13 Dhjetori”, nr. 1, Shkodër;
- nëpërmjet postës elektronike: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al;
- gjatë seancave publike të përcaktuara në kalendar.

Mendimet, komentet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë procesit do të administrohen dhe do të merren në konsideratë gjatë shqyrtimit dhe formulimit të mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Shkodër mbi projektligjin.

Materiali për konsultim: Projektligji “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni shoqërues i përcjellë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Duke Ju falënderuar,

SEKRETARE

Sabina Danaj



**KALENDAR I KONSULTIMIT PUBLIK I BASHKISË SHKODËR PËR INFORMIMIN
DHE KONSULTIMIN E BANORËVE NË KUADËR TË PROCESIT TË REFORMËS
TERRITORIALE**

Nr.	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Këshillim publik me banorët e Njësive Administrative Rrethina, Pult, Shosh dhe Shalë	11.09.2026	Pranë Njësise Administrative Rrethina	14:00	Takim publik	Bisedë
2	Këshillim publik me banorët e Njësise Administrative Ana e Malit	14.09.2026	Njësia Administrative Ana e Malit, Shkolla "Idriz Hoxha"	16:00	Takim publik	Bisedë
3	Këshillim publik me banorët e Njësise Administrative Velipojë	15.09.2026	Njësia Administrative Velipojë, Salla e Mbledhjeve	14:00	Takim publik	Bisedë
4	Këshillim publik me banorët e Njësise Administrative Dajç	16.09.2026	Njësia Administrative Dajç, Salla e Mbledhjeve	14:00	Takim publik	Bisedë
5	Këshillim publik me banorët e Njësise Administrative Bërdicë	17.09.2026	Njësia Administrative Bërdicë, Shkolla "Agim Tafili"	16:00	Takim publik	Bisedë
6	Këshillim publik me banorët e Njësise Administrative Postribë	18.09.2026	Njësia Administrative Postribë, Salla e Mbledhjeve	14:00	Takim publik	Bisedë
7	Këshillim publik me banorët e Njësise Administrative Guri i Zi	21.09.2026	Qendra Komunitare në Gurin e Zi	14:00	Takim publik	Bisedë
8	Këshillim publik me banorët e Lagjes nr. 1 Lagjes nr. 2 Lagjes nr. 3 Lagjes nr. 4 Lagjes nr. 5	22.09.2026	Salla e Këshillit Bashkiak Shkodër	14:00	Takim publik	Bisedë